



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.168..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27 / 12 / 2023

VENDIM

Nr. 45 datë 27 / 12 / 2023

PËR

KONTROLLIN SHTETËROR 5 VJECAR TË DIGËS SË HEC FANGUT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.12.2023 mori në shqyrtim Raportin e përgatitur nga grupi i punës në lidhje me kontrollin 5 vjeçar të kryer në digën e HEC Fangut sipas kërkesave të nenit 37, pika 2 të VKM se mesiperme. Grupi i punës përbehej nga përfaqësuesit e KKDM, MIE, AKBN, dhe KTPD.

Në baze të konstatimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të grupit të punës të paraqitura në një raportin teknik të përgatitur nga grupi i punës si dhe bazuar në të dhënat e shfrytëzuesit të digës së HEC Fangut (AYEN AS Energji) të dhëna bashkëlidhur këtij Vendimi, rezulton se trupi i digës së HEC Fangut është në gjëndje të qëndrueshme dhe elementet kryesore të saj janë në funksion dhe të monitoruara në përgjithësi. Problematikat kryesore që janë vërejtur gjatë këtij kontrolli rezulton në sasinë e filtrimeve të cfaqura në zonën poshtë digës, mungesën e analizave dhe studimeve në lidhje me këto filtrime dhe origjinën e tyre, mungesën e një analize të sedimenteve në rezervuar dhe të matjeve batimetrike për përcaktimin e volumeve aktuale të ujit në këtë rezervuar si dhe mungesën e një sistemi alarmi bashkëkohor në zonën urbane poshtë digës për lajmërim në kohe reale të eventeve që mund të ndodhin

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm si dhe duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi, KKDM.

VENDOSI

- 1- Të miratoj Konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të punës bashkëlidhur këtij Vendimi në lidhje me kontrollin 5 vjeçar shtetëror të digës dhe rezervuarit të HEC Fangut
- 2- Ti kërkoj kompanisë AYEN AS Energji si shfrytëzues i digës dhe rezervuarit të HEC Fangut
 - a) Të marrë masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga grupi i punës në lidhje me instalimin e sistemeve të alarmit në digë dhe rrjetet e tyre të transmetimit në zonat urbane poshtë tyre duke u bazuar në nenin 28 dhe 35 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave" dhe Udhëzimit Nr. 248, datë 28.01.2000 të gjashtë Ministrive në lidhje me planet e alarmit si dhe hartat e përmbajtjeve në rastet e prurjeve maksimale apo prishjes së mundshme të digës;
 - b) Të dërgoj pranë KKDM Aktin e Kolaudit të veprës pas mbushjes për herë të parë të rezervuarit të shoqëruar me problematikat e vërejtura gjatë këtij procesi si dhe analizat përkatëse të shfrytëzuesit në lidhje me filtrimet e vërejtura, sjelljen e digës gjatë kryerjes së këtij procesi dhe cdo element tjetër që është konsideruar i rëndësishëm nga Shfrytëzuesi i digës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- c) Të pregatit dhe të dorëzoj pranë KKDM një raport të posacëm të shoqëruara me matjet në terren, konstatimet e vërejtura, analizat dhe konkluzionet në lidhje me ngjarjet sizmike të ndodhur gjatë periudhës 2017 - 2022
- d) Të pregatit një Raport të posacëm në lidhje me filtrimet e konstatuara në pjesën e poshtme të digës duke përfshirë analiza dhe studime profesionale në lidhje me origjinën dhe rruget e filtrimeve që dalin në pjesën e poshtme të saj, problematikat që mund të konstatohen gjatë kësaj analize në lidhje me sjelljen e digës, masat që duhet të merren për monitorimin në kohe reale, online dhe të plotë të sasisë dhe cilesisë së ujrave që dalin në këtë zonë. Ky Raport duhet të pregatitet dhe të dorëzohet pranë KKDM brenda muajit Qershor 2024.
- e) Të rikonstruktoj sistemin e monitorimit të filtrimeve në pjesën e poshtme të digës me synimin e grumbullimit, matjes dhe monitorimit automatik të të gjitha filtrimeve në kohe reale dhe online.
- f) Të kryejë matjet batimetrike në rezervuarin e krijuar nga kjo digë si dhe një analize profesionale të procesit të sedimentimit dhe monitorimit të tij në të ardhmen. Keto matje dhe analiza perkatese duhet të jepen në një raport të posacëm i pregatitur nga specialiste të fushës dhe të dorëzohet pranë KKDM brenda muajit Qershor 2024. Raporti duhet të përfshijë një analize profesionale në lidhje me procesin e sedimentimit dhe sjelljes së mbetjeve të ngurta në rezervuar, matjeve që mund të jene kryer deri me sot, shkaqet e mbushjes së mbetjeve të ngurta, trendi i mbushjes së rezervuarit për vitet e ardhme, masat që do të merren për zvogelimin e trendit të derisotem si dhe për monitorimin e sedimenteve në të ardhmen.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

